

URDHËR
Nr. 1136, datë 30.12.2024

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën “b” të nenit 15 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në urdhrin nr. 117, datë 19.3.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë”; në urdhrin nr. 411, datë 20.9.2022, “Për miratimin e planit të kontigjencës për sëmundjen e influencës aviare”; dhe në urdhrin nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare”,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla në territorin e:

- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë sipas tabelës 4, të shtojcës 5, të urdhrit nr. 177, datë 28.3.2023, “Për miratimin e programit kombëtar të mbikëqyrjes së influencës aviare”, vetëm me autorizim të veterinerit zyrtar për në thertore, pasi është kryer testi i PCR-së dhe shpendët kanë rezultuar negativ ndaj Sëmundjes së Influencës Aviare dhe të jenë shoqëruar me certifikatën shëndetësore të lëvizjes së shpendëve, në territorin e:

- Njësive administrative Zall-Herr, Zall-Bastar, Shëngjergj dhe Kashar të Bashkisë Tiranë;
- Njësive administrative Kamzë dhe Paskuqan të Bashkisë Kamzë;
- Njësive administrative Bërxull dhe Prezë të Bashkisë Vorë;
- Njësive administrative Fushë-Krujë dhe Nikël të Bashkisë Krujë.

4. Urdhri nr. 1132, datë 28.12.2024, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e Sëmundjes së Influencës Aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj